

Fejton: “Pavarësia dhe fati i minoriteteve (1991-1992)” (15)

Shpërbërja e dhunshme e Jugosllavisë - e pashmangshme?

Nga liderët kryesorë, duket e qartë se Slobodan Milosheviqi, Radovan Karaxhiqi dhe ata përreth tyre bartin përmasën më të madhe të përgjegjësisë për kthimin e një situatë të vështirë në një luftë të përgjakshme dhe shkatërrimtare. Në këtë ata u ndihmuan nga nacionalizmi dhe uria për territore të Franjo Tugjmanit, idiotësia e qeverive evropiane dhe pasiviteti i Shteteve të Bashkuara

Kur intervenimim ushtarak ndodhi, me arritjen e vet, Forca Mbrotjtëse e Kombeve të Bashkuara (UNPROFOR) nuk erdhi të parandalojë agresionin ose pushtimin, por më shumë që të zbatojë një armëpushim ndërmjet serbëve dhe kroatëve, një armëpushim që përkohësisht i la 30 për qind të Kroacisë në duart serbe dhe i liroi forcat serbe në Bosnjë.

Shkurt, evropianët u dëshmuan të papërvojë në trajtimin me palët e përkushtuara, të papajtueshme në një rajon që ata e konsideronin më pak të civilizuar se vetja. Por, evropianët së paku u përfshinë.

Shtetet e Bashkuara, pjesëmarrja e të cilave do të dëshmohej esenciale në fund, qëndruan anash. Duke ngurruar dhe me mungesë të vendosmërisë, bashkësia ndërkombëtare përfundoi duke i nxitur tensionet që ishin në rrënjë të konfliktit.

Megjithatë, është esenciale të njihet se Evropa nuk i krijoi ato tensione dhe se nuk ishte përgjegjëse për aktet e atyre që i nxitën ose i bënë luftërat, ose për spastrime

etnike, krime dhe masakra që i karakterizuan ato.

Për një kohë, ishte kalim kohe për ata që ishin të përfshirë që të gjenin fajtorin themelor. Nuk ishte për t'u befasuar që secili grup etnik e fajësonte një apo më shumë grupe të tjera.

Në situatat e pazgjidhura, siç është ajo në Kosovë, kjo edhe më tej vazhdon të jetë rastësi.

Nga liderët kryesorë, duket e qartë se Slobodan Milosheviqi, Radovan Karaxhiqi dhe ata përreth tyre bartin përmasën më të madhe të përgjegjësisë për kthimin e një situatë të vështirë në një luftë të përgjakshme dhe shkatërrimtare. Në këtë, ata u ndihmuan nga nacionalizmi dhe uria për territore të Franjo Tugjmanit, idiotësia e qeverive evropiane, dhe pasiviteti i Shteteve të Bashkuara.

Dhe megjithatë nuk bën të mos shikohet edhe konteksti më i gjerë në të cilin ngjarjet ndodhën. Shumica e vendeve që tash janë vetë anëtare të Bashkimit Evropian kaluan nëpër trazira të përgjakshme dhe të dhunshme para se harta e Evropës perando-

rake, ashtu si ishte rreth vitit 1850, të jetë përkufizuar plotësisht në një hartë me shtetet pak a shumë homogjene në aspektin etnik.

Jugosllavët janë lënë prapa në këtë proces. Historiani Holm Sundhaussen e ka quajtur pjesën e shkullit e 20-të prej vitit 1914 deri në vitin 1989 një “shekull i humbur” për Ballkanin.

Derisa pjesa tjetër e Evropës po luftonte në luftën e madhe qytetare (1914-1945) që në fund e pastroi terrenin për t'i lënë vend një strukture të re të komunikimit ndërkombëtar, shtete e Ballkanit janë thurur në probleme të vështira të vendosjes së shteteve të reja.

Pas Luftës së Dytë Botërore ato e gjetën veten të ngulfatura brenda sferës sovjetike, ose, në rast të Jugosllavisë, nën një diktaturë që dukej liberale vetëm krahasuar me modelin sovjetik.

Si pasojë, kur komunizmi pësoi kolaps, asnjë nga popujt e Jugosllavisë nuk e kishin kaluar procesin e vështirë dhe të ndërlikuar të negociimit dhe ndryshimit që e krijoi Bashkimin



Evropian.

Në vend të kësaj, liderët sikur Milosheviqi dhe Tugjmani, sikur edhe përkrahësit e tyre, kishin ide për sigurinë dhe dinjitetin kombëtar që u kishte kaluar koha për së paku dy, e mbase edhe më shumë gjenerata.

Milosheviqi posaçërisht besonte se ai mund të përdorë çështjen e të drejtave minoritare në një mënyrë që ishte konsistemnte me mënyrën në të cilën çështja është përdorur për qëllime agresive nga Gjermania gjatë kohës mes dy luftërave botërore.

Por Evropa kishte ndryshuar. Fuqia e bazuar kryesisht në pushtimin e territorit tash konsiderohej jolegjitime.

Qartë, lloji i lidërshit që kishin serbët dhe kroatët e bëri një situatë të vështirë jo vetëm më të rëndë, por shumë e shumë më të

rëndë.

Mungesa e vullnetit e Evropës dhe Shteteve të Bashkuara që të ndërmarrin veprime me forcë në fazat e hershme po ashtu ka luajtur një rol të rëndësishëm në lejimin e situatave të rrezikshme që të dalin jashtë kontrollit, së paku deri në vitin 1995.

Në anën tjetër, marrë parasysh se sistemi ndërkombëtar i jep legjitimitet dhe autencitet kryesisht shtetve kombëtare, dhe marrë parasysh se të drejtat e njeriut dhe ato minoritare janë bërë dogmë qendrore të atij sistemi, është vështirë të shihet se si cilido lidërship do të kishte mundur ta shpëtojë Jugosllavinë solicaliste ose të rikonsturktojë republikat e sajanë shtete të reja pa konflikt serioz.

(FUND)

Fejton: “Kumbara i nëntokës” (17)

Capone i hidhëruar

Eliot Nessi e thirri Al Caponen me telefon dhe i tha se duhet të dilte në dritare dhe ta shikonte një befasi që ia kishte përgatitur. Al Capone shikoi nga dritarja dhe mbeti me gojë të hapur

Al Capone kishte shumë nofka. Shokët e quanin “Scarface” (Fytyra me vrage) ose edhe “Fatlips” (Buzëtrashë). Punëtorët dhe rrogatërit e tij e quanin “Big Al” (Ali i madh). Mirëpo, vetëm miqtë më të ngushtë dhe familja guxonin ta thërrisnin me nofkën “Snorkey”. Vetëm miqtë dhe një armik: Eliot Nessi.

Eliot Nessi dhe ekipi i “Të paprekshmëve” të tij kishin arritur të sekuestronin sasi të madhe të alkoolit të Capones. Mirëpo, Nessit kjo nuk i mjaftonte. Ai donte ta poshtëronte Caponen dhe në fund ta mbyllte në burg. Capone u përgjigj duke urdhëruar ta vrasin një polic që ishte i afërt me Nessin. Kjo e bëri detektivin edhe më të vendosur në luftën kundër krimit. Nessi tashmë i kishte sekuestruar 45 kamionë me alkool nga Capone. Bile, depoja ku qeveria e linte gjithë atë mall nuk ishte aq e madhe për të gjithë atë sasi të rakisë. Nessi dha urdhër që malli të dërgohej në një depo më të madhe, shumë më të madhe. Mirëpo, para se ta dërgonte mallin në atë depo, ai vendosi që të bisedonte njëherë me Caponen.

Detektivi e rrokut telefonin dhe thirri në hotel “Leksington”, ku

ishte selia e Capones. Kërkoi të fliste me mafiozin e madh. Al Capone e kapë dëgjuesen, pa ditur se kush ishte në anën tjetër të telit.

“Dëgjo këtu, Snorkey”, kishte folur Eliot Nessi. “Jam Eliot Nessi. Kam një haber për ty. Sot në orën 11 dil deri në dritare se e kam një sihariq për ty”.

“Çka ashtu?” - kishte pyetur Capone, me një zë që po tregonte një fije nervoze.

“Do ta shohësh”, kishte qeshur Nessi.

Al Capone kishte dalë në dritare në orën 11 të shihte se për se e kishte pasur fjalën detektivi Ness. Nga dritarja pa kolonën e gjatë të 45 kamionëve që i ishin sekuestruar nga detektivët e Nessit. Gangsterët e Capones po e shikonin mallin e tyre që po u dërgohej në një depo të madhe shtetërore, pa guxuar të bënin gjë. Kamionët po ecnin ngadalë. Shumë ngadalë. Për inat të Capones. Capone e kishte rrudhur fytyrën i hidhëruar. Eliot Nessi po i zgërdhihej nga njëri prej kamionëve.

“Me këtë deshëm t'i tregonim forcën e ‘Të paprekshmëve’”. Deshëm ta hidhëronim, duke i treguar se ishim të gatshëm ta luftonim deri

në fund të fundit”, kishte thënë Eliot Ness më pas.

Al Capone ishte tërbuar fare. Kur kishte përfunduar parada e kamionëve të sekuestruar, Capone e kishte goditur me grusht tavolinën e tij të punës, i kishte thyer disa xhama të vitrinave dhe disa tavlla të cigareve. Eliot Nessi jo vetëm që po luante me nervat e tij, por edhe po i shkaktonte humbje prej shumë miliona dollarësh, duke i sekuestruar mall. Që gjërat të bëheshin edhe më keq për mafian, Eliot Ness i ra në gjurmë edhe një linjeje të re të kontrabandës së Capones. Brenda një dite zuri 20.000 galonë birrë. Eliot Nessi kishte nisur ta ndiente erën e triumfit. Al Capone nuk po mund të ndiente asgjë nga inati dhe dëshpërimi.

(Në numrin e nesërm: Çka rezultuan hetimet për shmangie të tatimit? Sa para ofronte Capone për t'i kapur dy ish-kontabilistët e tij që do të dëshmonin në gjyq? Kur u deklaroi gazetarëve se do ta bënte një film për jetën e tij? Pse ishte me humor të mirë, kur e thirrën të dilte para gjykatësit?)



Gangsterë të tjerë të shquar

Sergei Mikhailov

Sergei Mikhailovi e kishte bërë një gabim të vogël dhe e kishin dërguar në burgun famëkeq sovjetik, në Gulag. Në Gulag kishte hyrë si një askush dhe aty ishte shoqëruar me disa nga kriminelët më të mëdhenj të nëntokës sovjetike. Kur kishte dalë pas disa vjetësh nga burgu, ai kishte dalë si një kriminel i rryer, me shpinë të fortë dhe lidhjetë mira. Sot konsiderohet shef i bandës më të madhe kriminale në Rusi, të quajtur Organizata Solsnetskaya.

Disa thonë se kjo është edhe banda më e fuqishme në botë që me 5000 anëtarë sa ka kontrollon biznese ilegale në Moskë, Miami, Geneve dhe në Lindje të Mesme. Organizata e tij merret me kontrabdanë me armë, larje parash. Është pronar i kazinove, i bankave, madje edhe i një aeroporti. Bashkëpunon me kartelet e Kolumbias dhe me mafian e Italisë. Më 1995 ka kaluar të jetojë në Geneve të Zvicrës, por është arrestuar tre vjet më vonë. Pas vrasjes së disa dëshmitarëve, është shpallur i pafajshëm dhe është kthyer në Rusi. Sot konsiderohet njeriu më i rrezikshëm ndër të gjithë gangsterët e tjerë të botës dhe ç'është më zi: është i lirë.

